ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	**622-24-8751-5-2-1**
Nr i brendshëm	**622-24-141-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Renovimi i shtëpis së kulturës në fshatin Zhur**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

TRIANGLE SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brigada 123
(Adresa)

Suharekë
(Vendi)

23000
(Kodi postar)

049 473 653
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Ukë Baftjaraj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

triangle.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

19.11.2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Biznesi me përgjegjësi të kufizuara TRIANGLE SH.P.K. SUHAREKË

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

*Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prizrenit me datë **26.08.2024** ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: **Renovimi i shtëpis së kulturës në fshatin Zhur** me nr. të prokurimit: **622-24-8751-5-2-1** dhe nr. të brendshëm: **622-24-141-5-2-1**. Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë me datë **16.09.2024** deri në ora **14:00**. Hapja e tenderit është bërë me datën e njëjtë, pra me datë **16.09.2024,** AK ka publikuar procesverbalin e hapjes në përmes platformës së prokurimit.*
Njoftimin** B58 **mbi** Vendimin e AK-s për rekomandimin e dhënies së kontratës dhe letrat standarde i ka publikuar me datë: **21.10.2024 ora 08:42.
Pas kërkesës për rishqyrtim të vendimit të datës 23.10.2024 Autoriteti Kontraktues e ka kthyer lëndën në rivlerësim.
Pas rivlerësimit Njoftimin** B58 **mbi** Vendimin e AK-s për rekomandimin e dhënies së kontratës dhe letrat standarde i ka publikuar me datë: **08.11.2024 ora 15:17.
*Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë: **"Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët"***
Me datën 13.11.2024 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për herë të dytë pasi që këtë herë AK ka shpërblyer me kontratë një O.E. tjetër të pa përgjegjshëm.
Me datë 15.11.2024 kemi pranuar vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzim të kërkesës si të pa bazuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesverbali i hapjes është pranuar me kohë përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Zyra e prokurimit e Autoritetit Kontraktues *Kuvendi Komunal i Prizrenit* me datën: ***26.08.2024*** ka publikuar njftimin për kontratë për prokurimin me nr. të prokuirmit dhe titull të lartcekur. Ne kemi shprehur interesim në lidhje me procedurën në fjalë me ç'rast kemi shkarkuar dosjen e tenderit dhe në bazë të krëkesave të kualifikimit, kemi dorëzuar të githa dokumentet e kërkuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Pasi kemi pranuar Vendimin B58 nga AK, kemi vërejtur se pa të drejtë jemi eleminuar si tenderues i pa përgjegjshëm dhe AK kishte vendosur që të shpërblen me kontratë një Operator Ekonomik të pa përgjegjshëm dhe me çmim më të lartë se oferta jonë. Të pa kënaqur me vendimin e AK-s ne **me datën 13.11.2024 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për herë të dytë** me të cilën kemi kërkuar që:

Autoriteti Kontraktues *Kuvendi Komunal i Prizrenit* automatikisht ta pezullon zbatimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ta rishqyrtonn vendimin me të cilin kanë propozuar për kontratë një O.E. të pa përgjegjshëm edhe përkundër se ne kemi dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët si dhe të nxjerrin:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik : TRIANGLE SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Renovimi i shtëpis së kulturës në fshatin Zhur** me nr. te prokurimit: **622-24-8751-5-2-1** te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet ne **Rivlerësim** dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.

Përndryshe do të detyrohemi që të parashtrojmë ankesë në Organit Shqyrtues të Prokurimit.
Edhe pas dokumentimit të shkeljeve të cilat i ka bërë AK me fakte dhe prova, AK në mënyrë të kundërligjshme pa i marr për bazë provat e paraqitura me pretendimet tona, na refuzon kërkesën tonë si të pa bazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë me nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, mendojmë që Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të këtij tenderi i ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

Neni 4 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022
Neni 38 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022
Neni 40 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT** në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe përkundër faktit se i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim per kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.) si dhe ka propozuar për dhënie të kontratës një Operator Ekonomik të pa përgjegjshëm si

dhe me rastin e paraqitjes së kërkesës për rishqrtim të njejtën e refuzon si të pa bazuar pa i marr për bazë faktet dhe provat e paraqitura nga ana jonë.

Në vazhdim do të sqarojmë në mënyrë të detajuar shkeljet që janë bërë gjatë vlerësimit të procedurës në fjalë:

Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT me datën 16.08.2024 ka bere publikimin e njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, nga i cili kemi vërejtur që në mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar si dhe nuk i ka zbatuar dispozita ligjore të legjislacionit të prokurimit sepse nuk kanë kerukar sqarime shtes sipas nenit 72 te LPP-se dhe RrPP-s të neni 38 paragrafi 38.5 ku eshte dashur te kerkohet sqarim shtes. Sipas LPP-së thuhet qartë që kerkesat për informata shtes (plotesim i ofertave ekzistuese) nga neni 65-71 janë të cekura qartë në mënyrë që të bëhet vlerësimi i drejtë dhe profesional i ofertave të pranuara.
Autoriteti Kontraktues Pas kërkesës tonë për rishqyritm, lëndën e ka kthyer në rivlerësim ku ka caktuar komisionin për ri-vlerësim por edhe pse ka aprovuar kërkesën tonë, përsëri nuk i ka marr për bazë faktet dhe provat me të cilat kemi dëshmuar që ne kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Andaj jemi të detyruar që përsëri të e faktojmë përgjegjshmërinë tone dhe po paraqesim faktet që AK me rastin e rivlerësimit , nuk është dashur të na eliminon neve, për arësye se kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të cilat i ka kërkuar vetë Autoriteti Kontraktues.

Nga njoftimi për dhënien e kontratës dhe letrës standarde për eleminimin tonë kemi parë që arësyeja e eleminimit tonë ka qenë arësye fiktive, vetëm për të na eleminuar neve. Autoriteti Kontraktues ka cekur që na ka eleminuar me arsyetimin se na mungojn:

--b. Një baqelor i diplomuar i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune te licensuar per hartimin e raporteve vlersimi i ndikimit. në mjedis (VNM) licencë të cilën e lëshon Ministria e Ambijentit dhe ekonomisë..

Deshmia b,-
- CV-ia,
- diploma,
- dëshmi mbi përvojën në punë,
-kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë.
- te licencuar për hartimin e raporteve vlerësimi i ndikimit. në mjedis (VNM) licencë të cilën e lëshon Ministria e Ambientit dhe ekonomisë. Gëzim Demelazaj-Licenca e skaduar me 12.08.2024 dhe nuk është e lëshuar nga Ministra e Ambienti dhe Ekonomisë, sipas kërkesës ne tender.
Ju nuk keni dëshmuar se licencën e ka posedua gjatë njoftimit për kontratë. Por licencën e ka marrë me datën 6/11/2024 ku ju e keni ngarkuar ne E-prokurim. Gëzim Demelezaj nuk ka pasë licence gjate kohës se njoftimit për kontratë. Afati për dokumente shtese ka qene deri me 5/11/2024 ora 16 00.

Sa i perket pretendimit te AK per Z. Gëzim Demelezi arësyetimi nuk qëndron pasi që sikur kemi cekur edhe me rasitn e kërkesës për rishqyrtim të datës 23.10.2024 inxhinieri në fjal ka bër kërkes për vazhdimin e licences mbi dy muaj para datës së skadimit. Ministria e ka pranuar kërkesën për vazhdimin e liqencës dhe e njëjta e ka aprovuar kërkesën si dhe i ka hartuar dhe nënshkruar licencat, mirëpo për pranimin e licencës ministria ka paraparë që të caktoj një datëe dhe shpërndarjen e tyre do ta bëj në mënyrë ceromoniale. Sa i përketë këtij

pretendimi është kërkuar nga AK që të i drejtohen ministrisë për nje sqarim më të detajuar. Por për çdo informatë në lidhje me këtë qështje Autoritet Kontraktues është dashur që në bazë të nenit 72 të LPP-s dhe nenit 38 të RrPP-s të kërkon sqarim në lidhje me dëshmitë e paraqitura me tenderin tonë sepse ne kemi ofruar ofertën me çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve pjesëmarrës.

Si provë më poshtë po e paraqesim kërkesën e bashkangjitur dhe të protokolluar e cila dëshmonë që inxhinieri në fjalë ka qenë i licencuar para dorëzimit të tenderit por që Autoriteti Kontraktues duke vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-s pa të drejtë na ka eleminuar për këtë dëshmi.
Provë: Kërkesa e inxhinierit e dorëzuar në ministri.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: DMMU
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No: 3708/24
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: /
Data / Datum / Date: 06.06.24
PRISHTINË / A No. 1

FORMULAR PËR KËRKESA

	Përshkrim i shkurtër i kërkesës	PO
Kërkesë për:	PËR VAZHDIM TË LICENCËS PËR HARTIMIN E VNM-SË	
VËREJTJE		

Emri dhe mbiemri i palës , adresa	GËZIM DEMELEZI Rr. LASGUSH PORADECI NR. 2 FERIZAJ
Numri i telefonit E-mail	044 173 088 gdemelezi@yahoo.com
Numri i mobilit	044 173 088
Nënshkrimi i palës	

Sekretari i Përhershëm, e-mail: zspm_maph@yahoo.com.
Tel: ++381 38 200 32 010, Fax: ++381 38 517 800, Rruga Nazim Gafurri 31, Prishtinë

Pra AK e ka patur të shkruar dhe të dokumentuar nga ana jonë disa herë që Licenca e inxhinierit është e përfunduar dhe se inxhinieri të cilin e kemi prezentuar me Licence ka patur kërkesën për vazhdim të licencës kërkes kjo e protokoluar para datës për njoftimin për kontratë dhe më pas ua kemi sqaruar që ka përfunduar edhe pagesa për këtë, ndërsa AK as që ka dashur të merr parasysh një gjë të tillë. Po ashtu ne ia kemi bashkangjitur edhe komunikimet me emailet zyrtare me ministrinë, mirëpo AK edhe më pastaj nuk ka dashur as të merret fare me ne duke na diskriminuar nga kjo procedurë e tenderimit.

Ne vetëm po ua argumentojmë që kemi qenë të pergjegjshëm në këtë procedurë dhe këtë po ua faktojmë edhe një herë me fakte ku të bashkangjitur i gjeni dy licencat në të cilat mund të shihni datat që Inxhinieri i prezentuar nga ne nuk ka qenë as edhe një ditë të vetme pa

Licencë ashtu siç AK ka pretenduar. Andaj faktet dhe provat të cilat po ua bashkangjesim na, argumentojnë që licencat kanë qenë valide dhe janë vazhduar me kohë nga ana e inxhinierit. Më poshtë po ua bashkangjesim licencat në të cilat mund të shihen datat nga të cilat vërtetohet që inxhinieri në fjalë ka pasur licencë valide.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja

Nr. i licencës: 42/19

LICENCË

[redacted], Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

VLENË PËR OFERTËN:
RENOVIMI I SHTËPISË SË KULTURËS NË FSHATIN ZHUR-KOMUNA PRIZREN
SHTATOR 2024

[redacted] DENELEJI
Inxh. i Dip. i ndërtimtarisë

Data e vlefshmërisë:
12.08.2019– 12.08.2024
Prishtinë

Fatmir Matoshi
Ministër i MMPH-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrstructure

Nr. i licencës: 42/19/24

LICENCË

[redacted]

Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

VLENË PËR OFERTËN:
RENOVIMI I SHTËPISË SË KULTURËS NË FSH. ZHUR

[redacted]
Inxh. i Dip. i ndërtimtarisë

Data e vlefshmërisë:
12.08.2024– 11.08.2029
Prishtinë

Dr. Liburn Aliu
Ministër i MMPH

Sa i përketë pretendimit të AK-s se nga cila ministri është lëshuar licenca, kjo nuk qëndron por është vetëm një pretendim fiktiv për tu munduar që ta arësyetojnë shkeljen e ligjit në mënyrë për të na eleminuar nga pjesëmarrja e mëtejme në këtë tender. Prandaj për këtë po ua sqarojmë që sot kabineti qeveritar nuk ka një ministri të Ambientit dhe Ekonomisë sikur ka qenë në kabinetet qeveritare të mëparshme dhe si duket AK kërkesën e kenë kopjuar nga ndonjë aktivitet i prokurimit i ngjashëm nga vitet e më parshme. Pra në vitin 2024 dhe në kabinetin qeveritar ekzistues një ministri të cilen AK e kenë potencuar nuk egziston më pasi qe dihet botërisht se ka patur ndryshime sa i perket ministrive. Pra një gjë të tillë po ua bashkangjesim që tashmë që nga viti 2021 kemi ministri të cilat janë bashkuar me qeverisjen aktuale dhe kompetente për lëshimin e licencave në fjalë është: **Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinorë dhe Infrastrukturës** ndërs Ministria e Ekonomisë është e ndarë Shih dëshmitë.

Përbërja [Redakto | Redakto nëpërmjet kodit]

Kabineti përbëhet nga ministrat e mëposhtëm:[2]

Portfolio	Ministër	Filloi mandatin	Përfundoi mandatin	Partia
Kryeministri i Kosovës	Albin Kurti	22 mars 2021	Incumbent	Vetëvendosja
Zëvendëskryeministër i parë për Integrime Evropiane, Zhvillim dhe Dialog	Besnik Bislimi	22 mars 2021	Incumbent	Vetëvendosja
Zëvendëskryeministre e dytë dhe Ministre e Punëve të Jashtme	Donika Gërvalla-Schwarz	22 mars 2021	Incumbent	Guxo
Zëvendëskryeministre e tretë për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut	Emilija Rexhepi	22 mars 2021	Incumbent	Partia e Re Demokratike e Kosovës
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Faton Peci	22 mars 2021	Incumbent	Guxo
Ministër për Komunitete dhe Kthim	Goran Rakiq	22 mars 2021	Incumbent	Lista Serbe
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Hajrullah Çeku	22 mars 2021	Incumbent	Vetëvendosja
Ministër i Mbrojtjes	Armend Mehaj	22 mars 2021	Incumbent	Politikan i pavarur
Ministre e Ekonomisë	Artane Rizvanolli	22 mars 2021	Incumbent	Politikane e pavarur

Liburn Aliu

Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Artane Rizvanolli

Ministre e Ministrisë së Ekonomisë

AK është dashur ta ketë të qartë çka përmban VNM kur e kanë vendosur si kriter, por edhe nëse në atë kohë se kanë patur të qartë, tashmë është dashur të konsulltohen me ndonjë ekspert të kësaj lëmie. Duke parë pretendimin e AK-s ne dyshojmë që ata nuk e kanë të qartë që as për çka shërben Licenca e VNM-së as çfarë raporte harton dhe as ku i dorëzon ato mirëpo të shkruhet që licenca nuk është e lëshuar nga Ministra e Ambienti dhe Ekonomisë eshtë për keqëardhje sepse në fund të fundit AK është një institucion i nivelit lokal që duhet të kenë komunikim me institucionet qeveritare për ti sqaruar gjërat. Pra në bazë të pretendimit të AK-s është e njejtë sikur të thuhet psh. nje diplomë e inxhinierit te hidroteknikes nuk është e lëshuar nga Universiteti i Prishtines dhe nuk mund të pranohet nga asnje isntitucion tjeter edhe pse ai mund të jetë me të njejtin titull.
Ju mund të bëni krahasimin e Licencave me Licencën e inxhinierit tonë dhe inxhinierit të OE të cilin e kanë rekomanduar për kontratë, shih permbajtjen e licencave: udhezimi Administrativ per Licencim te Hartuseve te Raporteve per Vlersimin ne Mjedis NR. 10/2017 pra të dy ministritë e kanë të njejten përmbajte.
Edhe një sqarim të cilin AK nuk e dimë a e kanë si informacion duke pasur parasysh që këtë kriter e kanë vendosur vetë ata, mirëpo në bazë të vlersimit të ofertave dhe komunikimin të cilin e kemi patur në qasje ne dokumentacion nuk e kanë kuptuar raportin e VNM-se. Pra një raport i tillë i hartuar nëse hartohet për projektin në fjalë **Renovimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Zhur** ai raport do të dorëzohet në Ministrinë e **Mjedisit** Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës. Pra për këtë ju lutemi që para se te ndërmerrni një vendim të konsultoheni me ndonjë ekspert të kesaj lëmie dhe do ta kuptoni që ne jemi shumë në rregull sipas kriterit të cilin AK e kanë vendosur në FDT.

Si argument po ua bashkangjesim licencat e inxhinierit te ofruar nga ne dhe inxhinieres se OE te propozuar për kontrate shih deshmit

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrastructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI lëshon:

Nr. i licencës: 42/19/24

Inxhinieri i kompanis tone

LICENCË

[redacted]

Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

VLENE PER OBJEKTIN:
RENOVIMI I SHTËPISË SË KULTURËS NË FSH. ZHUR

Data e vlefshmërisë:
12.08.2024— 11.08.2029
Prishtinë

Ministër i MMPHI

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine

Në bazë të nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03L/214 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MEA lëshon:

Nr. i licencës: 07/20

Inxhinieria e OE te rekomanduar

LICENCË

znj. [redacted] Bachelor i Ndërtimtarisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-ës

Data e vlefshmërisë:
27.10.2020— 27.10.2025
Prishtinë

Blerim Kuçi
Minister i MEA

Pra sikur është dokumentuar më lartë të dy Licencat janë të njejta, mirëpo sikur kemi sqaruar dhe argumentuar më lartë, për shkak të ndryshimit në kabinete qeveritare, në qeverisjen aktuale, licenca në fjalë lëshohet nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe jo nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit sepse përbërja qeveritare tani është ndryshuar dhe MEA nuk egziston më.

Nezir Rexhepi

3	Nezir Rexhepi	IDN	anëtarë	Z. prokurimit

Si dëshmi më lartë ua kemi bashkangjitur edhe emrin e njerit antar të komisjonit i cili njëherit ka qen edhe z. i prokurimit por mbi të gjitha gjatë këti aktiviteti ka qen edhe shumë diskriminues ndaj neve si ofertues, pra me zotrien në fjal neve gjat qasjes në dokumente kemi patur bashkbisedim ku quditërishtë nuk e ka patur as iden se qfar është VNM dhe për qfar shërben, të njejti i kemi sygjeruar që të konsultohet me ndonjë ekspert të kësaj lami dhe të kuptoj se qfar është VNM dhe për qfar shërben mirpo i njejti as nuk e ka ditur dhe as nuk ka qen i interesuar për ta kuptuar këtë Licencë duke e patur si qështje primare diskriminimin ndaj nesh si ofertuesi më i lirë ai edhe pas rivlersimit të ofertave ka shpërblyer me kontrat një OE të papërgjegjshëm (dhmth i njejti ka qen në vlersim dy herë dhe ka "gabuar" dy herë), ne kërkojm nga OSHP që të ja argumentoj që oferta jonë ka qen e përgjegjëshme.

Sa i përket OE **BAJRAM HA.GASHI B.I.** të radhitur si i dyti në bazë të çmimit ne nuk kemi shumë qartësi pasi që në qasje në dokumente nuk na është ofruar ndonjë dokument i tij pasi që i njejti ka patur të plotësuar Aneks 3 kërkesën për Sekretet Afariste ku jo çdo dokument është sekret afarist mirëpo sipas raportit të vlersimit ne kuptojmë që ky OE ka qenë i papergjegjshëm ashtu pasi që nuk e ka të plotësuar kërkesën e FDT-se:

b. Një baqelor i diplomuar i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune te licensuar per hartimin e raporteve vlersimi i ndikimit. në mjedis (VNM) licencë të cilën e lëshon Ministria e Ambijentit dhe ekonomisë.
3. e. Një ingjinjer i diplomuar i hidros me jo më pak se 5 vite përvojë pune.

Sa i përket OE **Ridvan Elezi B.I.** të rekomanduar për kontratë ne konsiderojmë që ky OE është i papërgjegjshëm dhe këtë do ta argumentojmë më poshtë:

Së pari dëmtohet buxheti duke e rekomanduar një OE i cili ka ofruar ofertën më të shtrejt se ne. Pra në këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1 të LPP-s pasi që Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Së pari dëmtohet buxheti duke e rekomanduar nje OE me të shtrejt se neve. Pastaj me veprimin e tillë Autoriteti Kontraktues nuk i përmbahet qëllimit të LPP-s që të fitohet vlera për paranë duke pasur kujdes që të shfrytëzohen mjetet në mënyrë të drejtë.

1.Tek kërkesat e përshtatshmërisë në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në pikën c) është para parë kërkesa si vijon: c) Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë . Dhe si dëshmi është kërkuar: c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Nga dokumentet e në të cilat na është dhënë qasje shihet që Vërtetimi i leshuar nga gjykata nuk është i noterizuar sipas FDT-se sikur është cekur më lartë.
OE i rekomanduar për këtë kriter sipas emrit dhe mbiemrit ka prezentuar te njejtin inxhinier ku ne kur kemi ber marrveshje me inxhinierin ne fjal ai ne diplom dhe liqenc e specifikon projektin te shkruar me dor se per cilin project kemi ber marrveshje nje gje te till nuk e dim a e ka edhe me OE te rekomanduar mirëpo mbi të gjitha këto neve vetem habitemi se si komisjoni gjatë vlerseimit na diskriminon neve si OE. Ne baz te raportit te vlersimit te komisjonit shih sqarimet ne foto.

Kapaciteti teknik dhe professional:
c. nje ingjinjer i diplomuar ose master të gjeodezisë me përvojë pune 5 vite pas diplomimit i licensuar nga AKK.

Shihet qartë që AK gjatë vlersimit të ofertave nuk ka qenë i njejtë për të gjithë pra nuk ka bërë vlersim të njejt për të gjithë OE gjatë vlerësimit të ofertave pasi që ne si OE na ka eliminuar për inxhinierin e hidroteknikes i cili nuk ka nostifikim të diplomes e të njejtën gjë nuk e ka bër me OE të rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti ka prezentuar inxhinierin e gjeodezis me diplomë nga një shtet tjetër.

e. Një ingjinjer i diplomuar I hidros me jo më pak se 5 vite përvojë pune.

Po ashtu për inxhinierin e Hidroteknikes nuk ka kërkuar nostifikim të diplomës i njejti posedon diplomë nga një shtet tjetër dhe këtu shihet qartë që AK ndaj neve si OE ka përdorur standarde të dyfishtë.

f. nje salldues të certefikuar të pajisur me certefikat të metaleve.

Qertifikata e Salduesit nuk është e notorizuar.

Kërkesa 4. d) Papuqe per ngjeshje,

OE i rekomanduar për kontratë nga ana e AK posedon vetëm një faturë të papuqes për ngjeshje mirëpo nuk posedon ndonjë transaksjon bankar apo ndonjë DUD për këtë pajisje andaj nëse është vetëm fatura e njejta do të duhej të kishte edhe konfirmimin e pageses.

Kërkesa 5 OE duhet të jetë i qertefikuar dhe i pajisur me këto standarde a. Certifikim ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune. b. ISO 9001 2015 - Sistemi i menaxhimit te cilësisë c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit

Nga dokumentet e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nga ana e AK shihet se i njëjti ka paraqitur dokumentin ISO 14001 te pezulluar apo të anuluar, pra ka paraqitur një dokument jo valid i cili mund të vërtetohet me një kërkim të thjeshtë në internet. Shi deshmin me poshte

Id e Certifikatës		W-221135-E
Titulli		N.P.N. "ALFA-ING"
Standardi		ISO 14001:2015 Certifikimi i sistemit për menaxhim mjedisor
Fushëveprimi	*EN	Architectural and engineering activities and related technical consultancy General construction of buildings and civil engineering works; All other works that are based on construction works.
	*SQ	Veprimtarit e arkitekturës dhe inxhinierisë dhe këshillime në lidhej me to; Veprimtarit në ndërtimin e lartë dhe të ulet; Të gjitha veprimtarit që kanë përbazë ekzekutimin e punëve ndërtimore
Data e publikimit		09.11.2022
Data e Leshimit te Fundit		09.11.2023
Data e Fillimit		08.11.2024
Akreditimi		World Accreditation Services LLC.
Statusi i Certifikatës		Pezulluar ose i Anuluar

Mbi të gjitha është për tu habitur fakti se si AK e shpallë një OE shumë më të shtrenjt se ne dhe në shumë pika i papërgjegjshëm. Pra këtu shihet qartë që AK ka vepruar në menyrë diskriminuse ndaj neve si ofertues në këtë aktivitet të prokurimit duke shkelur haptas dispozitat e neneve 6 dhe 7 të LPP-së dhe si rrjedhojë duke bërë një vlerësim jo profesional dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-s .

Besojmë që i kemi elaboruar pikat që ndoshta AK nuk i ka patur të qarta. Kërkojmë nga OSHP që të detyroj Autoritetin Kontraktues që ti respektojë në përpikshmëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këtë lloj te aktivitetit te prokurimit e në veqanti dispozitat të cekura më lartë të cilat janë shkelur nga AK dhe pas vërtetimit të fakteve dhe provave të lartckura të nxjerrni:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik : TRIANGLE SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Renovimi i shtëpis së kulturës në fshatin Zhur** me nr. të prokurimit: **622-24-8751-5-2-1**te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.**

ANULOHET **njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës një Operatori Ekonomik të pa përgjegjshëm** dhe lënda të kthehet ne **Rivlerësim** dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke pasur parasysh shkeljet të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues si më lartë, neve do të na shkaktohen dëme materiale sepse për përgatitjen e tenderit është angazhar staf i kualifikuar, janë bërë shpenzime për sigurimin e ofertës, shpenzimet per shërbime te avokatisë si dhe fitimi i humbur për shkak se sikur kemi dështmuar me faktet dhe provat më lartë edhe përkundër se kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët ne pa të drejtë jemi eleminuar nga ky tender.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*